



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 204 Akti**

**Nr. 300 Vendimi**  
**Tiranë, më 30.9.2020**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Firdes Shuli</b>	Kryesuese
<b>Etleda Çiftja</b>	Relatore
<b>Roland Ilia</b>	Anëtar

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, në datën 30.9.2020, në selinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Gjin Gjoni**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

**OBJEKTI:** **Ndërprerja e procesit të rivlerësimit kalimtar.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Germa “a”, e pikës 1, të nenit 64 dhe neni 65 i ligjit nr. 96/2016**, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Vendimi nr. 78**, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi vendimin nr. \*\*\*, datë 30.7.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, shkresën nr. \*\*\*, datë 30.7.2020, dërguar pranë KLGJ-së, për arsyet e heqjes dorë nga statusi i magjistratit nga subjekti i rivlerësimit, z. Gjin Gjoni, i cili ka kërkuar ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, si dhe e bisedoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Gjin Gjoni, gjatë periudhës së procesit të hetimit administrativ ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, z. Gjin Gjoni, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar më 15.11.2018, nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët: Firdes Shuli, Roland Ilia dhe Etleđa Çiftja.
3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 – 33 të ligjit nr. 84/2016; nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 – 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe, më tej, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas neneve 40 – 44 të ligjit nr. 84/2016.
4. Trupi gjykues, me vendimin nr. 1, datë 15.11.2018, vendosi të fillojë një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme, për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues, komisionere Firdes Shuli. Të gjithë anëtarët deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit.
5. Komisioni, me anë të postës elektronike<sup>1</sup>, në datën 17.1.2019 njoftoi subjektin e rivlerësimit se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka filluar procesin e rivlerësimit kalimtar, në përputhje me nenin 179/b të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit u njoftua me përbërjen e trupit gjykues, të shortuar më 15.11.2018 dhe iu kërkuar të deklaronte nëse ishte në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.
6. Në mbledhjen e datës 17.7.2020, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi arriti në përfundimin se provat në lidhje me kriterin e pasurisë kanë nivelin e provueshmërisë,

<sup>1</sup> E-mail, datë 17.01.2019, ora 02:39 pm “Komisioni – Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

me vendimin nr. 2, vendosi të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Gjin Gjoni, si dhe të njoftojë subjektin se ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, sipas përcaktimeve të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

10. Me anë të postës elektronike<sup>2</sup>, në datën 20.7.2020, subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi vendimin nr. 2 të trupit gjykues për mbylljen e hetimit kryesisht dhe kalimin e barrës së provës për kriterin e pasurisë. Subjektit iu bënë me dije të drejtat që gëzon sipas ligjit për: (i) njohjen me dokumentet e dosjes dhe marrjen kopje të tyre menjëherë pas marrjes së njoftimit; (ii) të drejtën për të thirrur dëshmitar apo marrjen e çdo prove mbështetëse; (iii) të drejtën për të paraqitur shpjegime apo prova me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit, jo më vonë se data 4.8.2020. Bashkëlidhur këtij *e-mail*-i, subjektit të rivlerësimit iu dërguan: (i) rezultatet e hetimit kryesisht në versionin *word* dhe *pdf*; (ii) analiza financiare në *excel*; (iii) shpjegimet mbi analizës financiare; dhe (iv) tabela e detajuar e shpenzimeve të udhëtimit.

11. Në datën 27.7.2020, subjekti, mori kopje të dokumentacionit fizik përbërës të dosjes dhe kërkoi shtyrjen e afatit të paraqitjes së shpjegimeve deri në datën 10.8.2020. Trupi gjykues e pranoi këtë kërkesë të subjektit.

12. Ndërkohë që Komisioni ishte në pritje të prapësimeve të rezultateve të hetimit nga subjekti në datën 30.7.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor me shkresën nr. \*\*\* prot., njoftoi Komisionin se në mbledhjen e tij të datës 30.7.2020 ka vendosur të miratojë kërkesën për dorëheqje të z. Gjin Gjoni, duke deklaruar mbarimin e statusit të subjekti të rivlerësimit si magjistrat në Gjykatën e Apelit Tiranë. Bashkëlidhur kësaj shkrese KLGJ-ja dërgoi kopjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 30.7.2020 .

13. Komisioni konstatoi se me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.7.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: (i) deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. Gjin Gjoni, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë, për shkak të dorëheqjes nga ky status; (ii) efektet e këtij urdhërimi fillojnë në datën 31.7.2020; (iii) një kopje e këtij vendimi i njoftohet z. Gjin Gjoni, sipas kërkesave të germës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016 , “ Për organet e qeverisjes së drejtësisë”, si dhe të bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit të subjekteve; (iv) kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

14. Megjithëse subjekti i rivlerësimit kishte paraqitur dorëheqjen me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.7.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor deklaroi mbarimin e statusit të magjistratit. Në datat 10, 12 dhe 13 gusht 2020, subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike<sup>3</sup>, paraqiti shpjegimet dhe provat e tij në përgjigje të rezultateve të hetimit kryesisht dërguar nga Komisioni në datën 20.7.2020.

---

<sup>2</sup> *E-mail*, datë 20.7.2020, ora 11:39, “Komisioni – Njoftim mbi mbylljen e hetimit kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit”.

## **II. ARSYET E PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT**

### **a. Orientimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit<sup>4</sup>**

15. Kolegji i Posaçëm Apelit në lidhje me praktikën e gjyqimit të çështjeve që lidhen me institutin e dorëheqjes së subjekteve të rivlerësimit nga procesi në fazën e ndryshme të tij, po kështu edhe pasojat juridike që sjell ndërprerja e procesit, orienton Komisionin që për zgjidhjen e këtyre çështjeve, duke respektuar parimin e transparencës në zhvillimin e procedurës së rivlerësimit të verifikojë vullnetin e pavesuar për dorëheqjen e dhënë, e cila duhet të ketë burim të ligjshëm një prej institucioneve të caktuara me ligj.

16. Si sanksion kushtetues për raste të ngjashme, Komisioni orientohet që, përveç ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, të vendosë edhe ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit gjyqtar ose prokuror të çdo niveli, anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor të Lartë të Drejtësisë ose Prokuror të Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

### **b. Verifikimi i vullnetit të pavesuar për dorëheqje**

17. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, në datën 30.7.2020 është depozituar njoftimi i vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor – *për mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes.*

18. KLGj-ja, bazuar në kërkesën për dorëheqje të bërë nga subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.7.2020, ka vendosur deklarinimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. Gjin Gjoni, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë. Për këtë vendim, krahas Komisionit, është njoftuar edhe subjekti i rivlerësimit, z. Gjin Gjoni.

19. Gjithashtu, Këshilli i Lartë Gjyqësor me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.9.2020, ka dërguar aktet e depozituara nga z. Gjin Gjoni për heqjen dorë nga statusi i magjistratit, respektivisht kërkesën e datës 17.7.2020, “Mbi dorëheqjen e parevokueshme nga statusi i gjyqtarit dhe funksioni i gjyqtarit të apelit” dhe kërkesën e datës 22.7.2020, “Mbi dorëheqjen e parevokueshme nga statusi i gjyqtarit dhe funksioni i gjyqtarit të apelit, me efekt të menjëhershëm”.

20. Më tej, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.9.2020, KLGj-ja ka informuar Komisionin se vendimi nr. \*\*\*, datë 30.7.2020, i është njoftuar z. Gjin Gjoni më 30.1.2020, në adresën postare elektronike. Gjithashtu, krahas njoftimit elektronik, KLGj-ja njofton se subjektit të rivlerësimit i është bërë njoftim dhe me postë në adresën e vendit të punës, në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe kjo e fundit me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.9.2020, ka informuar se vendimi nr. \*\*\*, i KLGJ-së, i është njoftuar personalisht, z. Gjin Gjoni, më 30.7.2020, vërtetuar me fletën e regjistrimit të protokollit të kësaj gjykate<sup>5</sup>.

21. Në bazë të informacionit të marrë nga Gjykata Administrative e Apelit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.9.2020, për vendimin nr. \*\*\*, datë 30.9.2020, “Për mbarimin e statusit të

<sup>4</sup> Referohu vendimit me nr. \*\*\*, datë 11.6.2018, paragrafëve 96 dhe 97, të Kolegjit.

<sup>5</sup> Bashkëlidhur shkresës së KLGj-së ka përcjellë shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.9.2020, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe fletën përkatëse të regjistrimit të protokollit të kësaj gjykate.

magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Tiranë z. Gjin Gjoni”, brenda afatit 15-ditor nuk është paraqitur ankim gjyqësor prej z. Gjin Gjoni.

### **c. Ftesa për seancë dëgjimore dhe qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

22. Për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe të drejtës që gëzon subjekti i rivlerësimit për t’u dëgjuar, bazuar në nenin 55, të ligjit nr. 84/2016, datë 22.9.2020, Komisioni ftoi në seancë dëgjimore subjektin e rivlerësimit, z. Gjin Gjoni, me anë të postës elektronike<sup>6</sup>, me qëllim që të shprehte në mënyrë të qartë dhe të pavesuar vullnetin mbi dorëheqjen nga statusi i magjistratit në seancë dëgjimore ose me anë të postës elektronike.<sup>7</sup>

23. Pas dërgimit të njoftimit për zhvillimin e seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, z. Gjin Gjoni, në datën 23.9.2020 me anë të postës elektronike<sup>8</sup>, ndër të tjera, deklaroi se: “ [...] *Që nga data 31.7.2020 nuk jam më në sistemin e drejtësisë dhe si gjyqtar i Gjykatës së Apelit Tiranë me një vendim të KLGj-së, i cili nuk është ankimuar. Ligji dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese e ka dhënë në mënyrë taksative mënyrën si vepron KPK-ja në këto raste [...].*”

24. Subjekti i rivlerësimit, po në datën 23.9.2020, me anë të postës elektronike<sup>9</sup>, ndër të tjera, deklaroi se: “ [...] *Dorëheqja sipas ligjit jepet përpara KLGJ-së dhe jo KPK-së [...], për sa kohë që KLGj-ja iu ka përcjellë vendimin e saj veproni sipas ligjit [...].*”

### **d. Ligji i zbatueshëm për ndërprerjen e procedurës së rivlerësimit**

25. Në germën “a”, pika 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se statusi i magjistratit mbaron kur jep dorëheqjen.

26. Neni 65, i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar procedurën që duhet ndjekur për mbarimin të statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes, si vijon:

*“1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës.*

*2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.”*

27. Neni G, i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon:

*“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.*

<sup>6</sup> Email datë 22.09.2020, ora 4:27 pm “Komisioni – Ftesë për seancë dëgjimore”

<sup>7</sup> Email datë 23.09.2020 ora 11:57 am “Re: Komisioni – Ftesë për seancë dëgjimore”

<sup>8</sup> Email datë 23.09.2020, ora 12:07 “FW: Komisioni – Ftesë për seancën dëgjimore”

<sup>9</sup> Email datë 23.09.2020, ora 12:16 pm “Fwd: Komisioni – Ftesë për seancën dëgjimore”

2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.

28. Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ka interpretuar, ndër të tjera, lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave, si vijon:

*“[...] Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G, të Aneksit të Kushtetutës [...]”.*

### **e. Arsytimi ligjor i fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm**

29. Trupi gjykues vlerëson duke pasur parasysh se:

29.1 Dorëheqja e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, z. Gjin Gjoni, nga statusi i magjistratit në Këshillin e Lartë Gjyqësor, është në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

29.2 Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organ i posaçëm kushtetues, me kompetencë lëndore për mbarimin e statusit të magjistratit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.7.2020, ka deklaruar mbarimin e statusit të magjistratit për z. Gjin Gjoni, bazuar në nenin 61 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, dhe nenin 65 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

29.3 Ky vendim i është njoftuar Komisionit, si organi i posaçëm kushtetues për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.7.2020, të KLGJ-së dhe Komisioni duke marrë në konsideratë të drejtën e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit ishte në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk kishte përfunduar ende, pezulloi procedurën e rivlerësimit deri sa vendimi nr. \*\*\*, datë 30.7.2020, i KLGJ-së, për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, të merrte formë të prerë.

29.5 Gjykata Administrative e Apelit<sup>10</sup> njofton se për vendimin nr. \*\*\*, datë 30.9.2020, “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Tiranë z. Gjin Gjoni”, nuk është paraqitur ankim gjyqësor brenda afatit 15-ditor, dhe z. Gjin Gjoni ka marrë njoftim edhe me postë elektronike edhe personalisht<sup>11</sup>.

29.6 Komisioni ftoi në seancë dëgjimore subjektin e rivlerësimit z. Gjin Gjoni, me anë të postës elektronike, me qëllim që të shprehte në mënyrë të qartë dhe të pavesuar vullnetin mbi dorëheqjen nga statusi i magjistratit në seancë dëgjimore ose me anë të postës elektronike, për

---

<sup>10</sup> Shkresa e KLGJ-se nr. \*\*\* prot. datë 11.09.2020, protokolluar në Komision në datë 15.09.2020, bashkëlidhur shkresën nr. \*\*\* datë 01.09.2020, nga Gjykata e Apelit Administrativ.

<sup>11</sup> Këshilli i Lartë Gjyqësor me shkresën \*\*\* datë 11.09.2020, informoi Komisionin se Vendimi i KLGJ-së nr. \*\*\* datë 30.07.2020, i është njoftuar z. Gjin Gjoni në datë 30.01.2020, në adresën postare elektronike. Krahas njoftimit elektronik, KLGJ njofton se subjektit të rivlerësimit i është bërë njoftim dhe me postë në adresën e vendit të punës, në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe kjo e fundit me shkresën nr. \*\*\* datë 09.09.2020, ka informuar se vendimi i KLGJ-së nr. \*\*\*, i është njoftuar personalisht z. Gjin Gjoni më datë 30.07.2020, vërtetuar me fletën e regjistrit të protokollit të kësaj gjykate

zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe të drejtës që gëzon subjekti i rivlerësimit për t'u dëgjuar, bazuar në nenin 55, të ligjit nr. 84/2016, në datën 22.9.2020.

29.7 Pas dërgimit të njoftimit për zhvillimin e seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, z. Gjin Gjoni, në datën 23.9.2020, me anë të postës elektronike, ndër të tjera, deklaroi se: “ [...] Që nga data 31.7.2020 nuk jam më në sistemin e drejtësisë dhe si gjyqtar i Gjykatës së Apelit me një vendim të KLGJ-së, i cili nuk është ankimuar. Ligji dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese e ka dhënë në mënyrë taksative mënyrën si vepron KPK-ja në këto raste [...].”

29.8 Subjekti i rivlerësimit, po në datën 23.9.2020, me anë të postës elektronike, ndër të tjera deklaroi se: “ [...] Dorëheqja sipas ligjit jepet përpara KLGj-së dhe jo KPK-së [...], për sa kohë që KLGj-ja ju ka përcjellë vendimin e saj veproni sipas ligjit [...].”

30. Trupi gjykues vlerëson se vullneti i plotë dhe i pavesuar i subjektit të rivlerësimit për dorëheqje konfirmohet nga deklaratimet e tij më lart.

30. Bazuar në sa më lart, trupi gjykues çmon se procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Gjin Gjoni, duhet të ndërpritet, duke u bazuar në parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

31. Ndërprerja e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, gjatë procesit të rivlerësimit, sjell si pasojë ndërprerjen e kësaj procedure administrative dhe subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 57, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në germën “b”, të nenit 89, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015 dhe në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë,

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Gjin Gjoni, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.
2. Ndalimin e emërimit të z. Gjin Gjoni, si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

3. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
  4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall në datën 30.9.2020.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Firdes SHULI**  
**Kryesuese**

**Etleda ÇIFTJA**  
**Relatore**

**Roland ILIA**  
**Anëtar**

*Sekretare gjyqësore*  
*Olsida Goxhaj*